



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primiçeno/Prodato Received/Delivered	16-03-2021	1	viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojka Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHTEK	1191/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.55/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi – Bajraktari, anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.55/2021, të datës 04.02.2021, të parashtruar nga me adresë banimi rruga „ Sadik Stavileci”, nga Komuna e Gjakovës, kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.03.2021, mori këtë;

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr. 55/2021, e datës 04.02.2021, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokollit 01-112/02-30379 i datës 17.12.2020, i Kryetarit të Komunës së Gjakovës.

A r s y e t i m

Ankuesja më datë 04.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 01-112/02-30379 të regjistruar me A.nr.55/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me numër protokollit 01-112/02-30379 të datës 17.12.2020, të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, me pretendimin se avancimi i saj është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 05.02.2021 përmes shkresës me numër protokollit 521/2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Gjakovës. Ndërsa më datë 08.03.2021 Komuna e Gjakovës ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.03.2021 me numër protokollit 457/2021, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil Kosovës; Përshkrimi e detyrave të punës; Vendimin me numër protokollit 01-112/02-30379 të datës 17.12.2020 të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, E-mailin e datës 16.02.2021 nga F.K për R.K, E-mailin e datës 28.01.2021 nga F.K për V.N, Fletë pranimit e Vendimit me datë 06.01.2021, Përgjigjen në Ankesë të datës 16.02.2021, Vendimin me Nr.116-21952/2016 të datës 21.04.2016, Akt Emërimin më numër protokollit 112-

1713/5 të datës 12.03.2012, Aktgjykimin PKR Nr. 309/14 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Vendimin numër protokoli 01-112/02-30379 të datës 17.12.2020, Listën e pagave për nëntor 2020 dhe janar 2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pasi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet për pranushmerinë e ankesës dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses Valbona Naka, *është e pa bazuar sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar se me Vendimin me Nr.116-21952/2016 të datës 21.04.2016 të Kryetares së Komunës së Gjakovës, ankuesja në pozitën e Udhëheqëses së Kadastrit për Çështje Juridike pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, për shkak të fillimit të procedurës penale ndaj saj me dyshimin e kryerjes së veprës penale gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, ishte pezulluar me 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata.

Me Aktgjykimin PKR Nr.309/14 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i plotfuqishëm me datë 11.02.2020, ankuesja është liruar nga akuza, dhe e njëjta më datë 27.11.2020 ka parashtruar kërkesë të organi i punësimit për rikthim në vendin e punës.

Me Vendimin me numër protokoli 01-112/02-30379 të datës 17.12.2020, të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, ankuesja është rikthyer në pozitën e punës Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Pronësore Juridike, pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, e të cilin Vendim ankuesja e ka pranuar përmes postës më datë 06.01.2021.

Në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ankuesja pretendon se Kryetari i Komunës së Gjakovës me Vendimin numër protokoli 01-112/02-30379 të datës 17.12.2020, ka bërë avancimin e saj pa zhvillimin e procedurave për avancim.

Organi i punësimit-Komuna e Gjakovës në përgjigjën në ankesë deklaroi se ankuesja para pezullimit të saj ka mbajtur pozitën e Udhëheqëses së Kadastrit për Çështje Juridike pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, e cila pozitë pas hyrjes në fuqi të Katalogut për titujt e Vendeve të Punës në Shërbimin Civilë nuk ekziston si e tillë, dhe për këtë arsye në pajtim me Katalogun e Vendeve të Punës i miratuar nga Ministria e Administratës Publike si dhe Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës Shërbimin Civilë, ankuesja është emëruar në pozitën e Udhëheqëse e Sektorit për Çështje Pronësore Juridike. Me tutje deklarohet se ankuesja ka koeficient të njëjtë të pagës sikurse në pozitën paraprake të punës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil si ligj i zbatueshëm në kohën kur ankuesja është pezulluar nga puna me 50% të pagës përkatësisht neni 63 paragrafi 5 ku përcaktohet se: *Nëse nëpunësi civil i akuzuar për kryerje të veprës penale shpallet i pafajshëm: 5.1. ai/ajo do të kthehet në vendin e punës dhe në dosje nuk do të përfshihet asnjë përmendje e procedurës penale dhe/ose pezullimit parandalues;* si dhe Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë respektivisht nenin 58 me të cilin përcaktohet se: *Pas përfundimit të pezullimit, përveçse kur vendoset përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil, sipas këtij ligji, nëpunësi civil rikthehet në pozitën e mëparshme të punës ose në rast se pozita e mëparshme është e plotësuar përfundimisht, ai transferohet në një vend tjetër të së njëjtës kategori.* Në rastin e pezullimit për një afat deri në 3 muaj, pozita e mëparshme e punës nuk plotësohet deri në përfundimin e pezullimit. Rrjedhimisht Kolegji vlerëson se caktimi i ankueses në pozitën e Udhëheqëses së Sektorit për Çështje Pronësore Juridike, pas lirimit të saj nga aktakuza sipas Aktgjykimit PKR Nr.309/14, është në pajtim me dispozitat ligjore të lartë cekura dhe rikthimi i ankueses në këtë pozitë pune nuk nënkupton avancimin e saj por sistemin e të njëjtës në pozitë tjetër pune të së njëjtës kategori. Andaj pretendimi ankimor në këtë kuptim është i pa bazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës bazuar në provat e lëndës vëren se aktualisht Komuna e Gjakovës nuk ka ndonjë Rregullore lidhur me organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, kështu që Kolegji për vendosje të kësaj çështje si fakte relevante dhe të besueshme mori deklarin e organit të punësimit se pozita paraprake në të cilën ankuesja ka qenë e sistemuara para pezullimit është shuar dhe



sistemimi i ankueses pas aktgjykimit lirues është bërë në një pozitë të re bazuar në Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.55/2021, datë 16/03/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankueses Valbona Naka,*
- *Kryetarit të Komunës së Gjakovës,*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*